



YOUTH INITIATIVE FOR HUMAN RIGHTS
INISALË E REJVE PËR LË DREJTAT E NËNËT
INICIJATIVA MËNJËRITIA ZA LJUDSKA PRAVA

Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

01
Nr./Br. MB/01-1507
Data/Datum 19. 01. 2021
Gjakovë, Djakovica-Gjakova



Memorandum Bashkëpunimi

në mes të

Youth Initiative for Human Rights - Kosovë (YIHR KS)

dhe

Komunës së Gjakovës

Lidhur me themelimin e një bashkëpunimi më të ngushtë midis institucioneve të qeverisjes lokale dhe shoqërisë civile, specifikisht bashkëpunimin e Youth Initiative for Human Rights - Kosovë (në vazhdim si YIHR KS) me Komunën e Gjakovës (në vazhdim Komuna).

Duke pasur parasysh qëllimin e YIHR KS që të kontribuojë në rritjen e kapaciteteve të të rinjve dhe transparencës së institucioneve publike;

Duke pasur parasysh qëllimin e Komunës për të zhvilluar shkathtësitë profesionale praktike të qytetarëve e studentëve dhe të ju ofrojë mundësi atyre të kontribuojnë në komunitet, gjithashtu edhe të promovojë punën e tyre në shoqëri;

Duke pasur parasysh qëllimet e YIHR KS dhe Komunës së Gjakovës, palët pajtohen si në vijim:

1. Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi është të lehtësojë bashkëpunimin në mes të YIHR KS dhe Komunës në kuadër të fushëveprimit të organizatës që për qëllim ka të fuqizojë të rinjtë të kërkojnë drejtësi dhe të bëhen pjesëmarrës aktivë në sektorin e drejtësisë në Kosovë si dhe të rrisë qasjen në drejtësi në nivelin komunal.

2. Përgjegjësitë e Komunës së Gjakovës

Në frymën e bashkëpunimit drejt arritjes së qëllimit të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, Komuna pajtohet të përmbushë përgjegjësitë individuale të mëposhtme:

- a) Komuna i lehtëson YIHR KS qasjen në hapësirat e saj publike për organizimin e aktiviteteve në kuadër të fushëveprimit të saj.
- b) Komuna u mundëson tre studentëve të mbajnë punë praktike tre (3) mujore në institucionin e saj në kuadër të projektit “Rritja e qasjes në drejtësi në nivel komunal”;
- c) Komuna lehtëson zhvillimin e aktiviteve në nivel komunal.

3. Përgjegjësitë e YIHR KS

Në frymën e bashkëpunimit drejt arritjes së qëllimit të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, YIHR KS pajtohet të përmbushë përgjegjësitë individuale të mëposhtme:

- a) YIHR KS zotohet të mos dëmtojë hapësirat publike në rastet kur organizon aktivitete rrugore në komunën e Gjakovës;
- b) YIHR KS do të përzgjedhë dhe koordinojë të gjithë studentët për të kryer praktikën në Komunë për periudhën tre (3) mujore;
- c) YIHR KS do të bëjë kontraktimin dhe pagesën e studentëve të përzgjedhur.

4. Kohëzgjatja e Memorandunit

Ndryshimet dhe modifikimet mund të bëhen vetëm pas kërkesës me shkrim nga cilado palë dhe mund të hyjnë në fuqi vetëm pas konsultimeve dhe marrëveshjes nga të dy palët. Ky Memorandum Bashkëpunimi mund të ndërpritet në mënyrë të menjëhershme nga cilado palë me pëlqim të përbashkët, ose tre muaj pas njoftimit me shkrim dërguar palës tjetër. Ky Memorandum hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

5. Kopjet e Memorandunit të Bashkëpunimit

Ky Memorandum Bashkëpunimi është përgatitur në dy kopje identike, nga një (1) për secilën palë nënshkruese të këtij dokumenti. Ky memorandum është përgatitur në gjuhën shqipe.

Znj. Marigona Shabiu




Drejtoreshë Ekzekutive

Data: 19/01/2021

Z. Ardian Gjini




Kryetar i Komunës së Gjakovës

Data: 19.01.2021